



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
Nr. / Br.	24974/25
Nr. i fq. / Br. st.	- 2 -
Date: / Datum:	05.06.2025
VUSHTRRI - VUČITRN	



**Republika e Kosovës**

**Komuna Vushtrri**

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**

**Datë: 05 qershor 2025**

Bazuar në Rregulloren (KKV) nr.08/20 për Dhënien e Dekoratave si dhe Planin e Punës së Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë – Qeverisë Komunale për vitin 2025, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Vushtrrisë, shpallë:

**KONKURS LETRAR TË POEZISË PËR FESTIVALIN:  
“TAKIMET E POETTESHAVE SHQIPTARE 2025”**

Komuna e Vushtrrisë do të organizojë edicionin e 43-të të Festivalit "Takimet e Poeteshave Shqiptare 2025", në të cilën inkurajohen, që me poezitë e tyre të konkurojnë krijueset shqiptare nga të gjitha trojet shqiptare, përfshirë edhe poetet nga mërgata.

**Qëllimi i konkursit**

- Ruajtja, kultivimi dhe zhvillimi i kulturës dhe letrave shqipe te femrat shqiptare;
- Nxitja, motivimi dhe promovimi i poeteve shqiptare.

**Kushtet për pjesëmarrje**

- Poetet të konkurojnë me emër dhe mbiemër dhe të janë të moshës mbi 18 vjeçë;
- Poetet të konkurojnë vetëm me nga një poezi;
- Formati i shtypit dhe shkronjave duhet të jetë: Microsoft Word, Time New Roman,12;
- Poezitë duhet të janë në gjuhën shqipe, dhe të pabotuara më parë;
- Poezitë të dërgohen vetëm përmes postës elektronike në adresën [tpsh2025@gmail.com](mailto:tpsh2025@gmail.com) (Secilës poete i konfirmohet me kohë pranimi i poezi së përmes postës elektronike);
- Poetet, së bashku me poezitë e tyre sugjerohet t'i dërgojnë edhe dy numra kontakti (të qasshëm në çdo kohë), një biografi të shkurtër të krijimtarisë së poetes dhe një foto portret. 21 poete do të përzgjidhen për të vazhduar në fazat e mëtejme të konkurrimit, dhe ato do të njoftohen me kohë për detajet tjera në lidhje me organizimin e festivalit.

### Afati i dërgimit të poezive:

- Afati i dërgimit të poezive është i hapur **15 ditë**, nga dita e shpalljes.

Poezitë do të vlerësohen nga një juri profesional, e cila do të bëj vlerësimin e poezive brenda një afati të arsyeshëm, pa pasur dijeni mbi autoren, por vetëm në bazë të shifrës. Juria do të përmbyllë procesin e vlerësimit para datës së mbajtjes së festivalit, ndërsa ndarja e çmimeve do të bëhet në ditën e mbajtjes së festivalit. Për pjesëmarrje në festival do të kontaktohen vetëm poetet, poezitë e të cilave janë për zgjedhur për të vazhduar në fazën e dytë të konkurrimit, pasi të caktohet data e mbajtjes së festivalit nga organizatori i festivalit.

Në këtë festival, në bazë të rregullores komunale, do të ndahen këto çmime për poezi:

Çmimi i parë.....	500 €
Çmimi i dytë.....	300 €
Çmimi i tretë.....	200€
Debutuesja (poetja më e re në moshë, dhe që merr pjesë për herë të parë).....	100 €

Për të gjitha poetet, poezitë e të cilave do të përzgjidhen nga juria, për pjesëmarrje në festival, organizatori mbulon shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit.

Për informata më të hollësishme mund të shkruani në e-mail adresën: [tpsh2025@gmail.com](mailto:tpsh2025@gmail.com)

